



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 324/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur lidhur me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, të paraqitur ndaj subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të vendosjes së posterëve në afërsi të institucioneve publike, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.324/2019 e datës 06.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të vendosjes së posterëve në afërsi të institucioneve publike, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

Me datë 06.10.2019, Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, ka paraqitur në PZAP, ankesën Anr.324/2019, kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, me të cilën ka pretenduar, se më datë 06.10.2019, në ditën e zgjedhjeve, rreth orës 11:50, në Komunën e Graçanicës, janë parë posterë të subjektit politik Lista Serbe, me numrat e kandidatëve për deputet, të ngjitura në rrethojat e shkollës “Kraj Milutin”, veprim ky i cili sipas paraqitësit të ankesës bie në kundërshtim me Rregullën Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, përkatësisht nenin 3, pika 3.4 të rregullës në fjalë, duke shtuar se pavarësisht faktit se komuna, këto vende i ka paraparë si vende në të cilat mund të vendosen posterët, ato janë pranë shkollave, brenda perimetrit 100 metërsh, dhe janë në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret. Paraqitësi i ankesës si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një fotografi të printuar, në cilësi të provës materiale.

PZAP-i, konform nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, njoftoi subjektin politik Lista Serbe, për ankesën e paraqitur ndaj tyre, me afat për përgjigje deri më datë 07.10.2019, në ora 13:00, mirëpo deri në këtë kohë nuk u pranua asnjë përgjigje nga ana e tyre.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar, për këto arsye:

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Në rastin konkret, Paneli nuk mundi të konstatoj se nga ana e subjektit politik Lista Serbe, është shkelur dispozita ligjore e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, për faktin se paraqitësi i ankesës, ankesës nuk i ka bashkangjitur dëshmi të qarta dhe bindëse për të argumentuar pretendimet e tija, se nga ana e subjektit politik Lista Serbe janë shkelur dispozitat e Rregullës së lartëcekur zgjedhore.

Nga fotografia e bashkangjitur si provë nga paraqitësi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet data, koha dhe as vendi i shkeljes së supozuar. Paraqitësi i ankesës pretendon se shkelja ka ndodhur në rrethojat e shkollës “Krajl Milutin”, në Graçanicë, mirëpo nga fotografia që ankuesi i ka bashkangjitur ankesës, shihen posterë të vendosur në rrethoja, por nuk vërtetohet pretendimi se rrethojat i takojnë shkollës “Krajl Milutin”, pasi që në foto nuk shihet asnjë objekt shkollor, mbishkrim se kemi tw bwjmw me objekt shkollor apo ndonjë shenjw tjetër sipas të cilës mund të identifikohet që është objekt shkollor dhe qendër e votimit.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk rezulton se në këtë rast ka ndodhur shkelje e dispozitave ligjore të LZP-së, e as e rregullave zgjedhore, dhe për rrjedhojë nuk ka bazë ligjore që ndaj subjektit politik Lista Serbe, të shqiptohet gjobë në kuptim 120 par 1 pika c) të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, nenit 117 dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, Paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.324/2019 më datën 07.10.2019

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.